



A.nr.39/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Merlinda Ramaj, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.39/2026, të datës 13.01.2026, të parashtruar nga ankuesja A.Sh. nga Podujeva, kundër organit të punësimit: Komuna e Podujevës, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1 nën, paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 03.06.2026, nxjerrë këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e parakohshme ankesa me numër A.nr.39/2026, e datës 13.11.2026, e parashtruar nga ankuesja A.Sh.

A r s y e t i m

Ankuesja A.Sh (*tutje referuar ankuesja*), më datë 13.01.2026 përmes emailit ankesa.kpmschck@rks-gov.net, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Njoftimit të datës 05.01.2026 të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Podujevës lidhur me refuzimin e aplikacionit në procedurën e pranimit me numër të referencës: RN00019049, për pozitën e punës *Zyrtar për Shërbime Sociale -Grupi i Përgjithshëm i shërbimeve sociale*, i shpallur nga Komuna e Podujevës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 15.01.2026 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Podujevës, ndërsa, kjo e fundit, më datë 22.01.2026 ka përcjellë përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës në çështjen përkatëse ankimore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të çështjes ka gjetur së ankesa **është parakohshme**, sepse:

Nga shkresave e lëndës rrjedhe së Komuna e Podujevës me datë 21.11.2025 ka shpallur konkursin me numër të referencës: RN00019049, Grupi i përgjithshëm i shërbimeve sociale, për pozitën “*Zyrtar për Shërbime Sociale*”- Podujevë, me afat aplikimi nga data 22.11.2025 deri më datë 21.12.2025.

Rrjedhimisht, sipas provave të lëndës del së në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesja, mirëpo, me Njoftimin e datës 05.01.2026 të Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Podujevës i është refuzuar aplikacioni pe arsyetimin se: *“nuk ka ofruar dëshmi për përfundimin e arsimimit në drejtimin e kërkuar (Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor), drejtimi Psikologji/Sociologji, Punë Sociale, Logopedi) të kërkuar sipas pikës 3 të shpalljes së konkursit.”*

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundërshton ligjshmërinë e Njoftimit të datës 05.01.2026 për refuzimin e aplikacionit, me pretendimet së ka bashkëngjitur diplomën e studimeve Bachelor në drejtimin Pedagogji e Përgjithshme e cili ka ndërlidhje në fushën e Psikologjisë, si dhe ka lidhshmëri akademike me fushën e *“...Logopedisë, në përputhje me kriteret e përcaktuara në pikën 3 të shpalljes së konkursit...”*. Shton se programi studimor i Pedagogjisë përfshin lëndë thelbësore nga psikologjia e zhvillimit, psikologjia edukative, komunikimit, mirëqenia sociale dhe zhvillimi i individit, të cilat janë drejtpërdrejtë relevante për pozitën e shpallur. Kërkon që vendimi të rishqyrtohet dhe të mundësohet vazhdimi në fazat tjera të rekrutimit.

Në kuptim të pranushmërisë së ankesës, Kolegji i Këshillit, ju referua dispozitave të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë gjegjësisht nenit 39 paragrafi 12 i cili përcakton se: *“12. Kandidatët/ët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK sipas afatit të përcaktuar në ligjin përkatës për procedurën administrative”*, si dhe nenit 17 të Rregullores Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimit Në Shërbimin Civil, me të cilin shprehimisht parashihet se: *“Kandidatët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK në afat prej tridhjetë (30) ditëve”*, dhe rrjedhimisht konstatoi se ankesa e ankueses e parashtruar më datë 13.01.2026, kundër refuzimit të aplikacionit për pozitën e lartcekur është e parakohshme, ngase, me dispozitat përkatëse ligjore, kandidatja për pranim në Shërbimin Civil ka të drejtë të parashtror ankesë vetëm pas shpalljes së rezultateve përfundimtare të procedurës respektive të rekrutimit, ndërsa, ankuesja ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e ka parashtruar kundër njoftimit për refuzim të aplikacionit si veprim procedural në fazën e shqyrtimit paraprak. Pra, meqenëse në kohën e parashtrimit të ankesës së ankueses të datës 13.01.2026, nuk kishte përfunduar procedura e pranimit sipas konkursit me Nr. Reference: RN00019049, rrjedhë se ankesa e ankueses A.nr.39/2026, e datës 13.01.2026, është e parakohshme dhe për rrjedhojë e njëjta është e palejueshme në kuptim të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në ndërlidhje me nenin 39 paragrafi 12 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë.

Lidhur me të drejtën në mjete juridike, Kolegji i Këshillit thekson faktin së hedhja poshtë si parakohshme e ankesës me numër A.nr.39/2026, nuk mohon të drejtën e ankueses që të kundërshtoj ligjshmërinë e refuzimit të aplikacionit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare si akt mbi përfundimin e konkursit lidhur me pozitën përkatëse.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE: Ky vendim hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë- Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda: A.nr.39/2026

Merlinda RAMAJ

Procesmbajtëse

Ardita HAXHNIKAJ DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- *Ankueses A.Sh;*
- *Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Podujevës; dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK-së.*